



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 54

17 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 250, datë 12.4.2012	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Kfw Frankfurt Am Main, për kontributin zviceran për financimin e projektit “Furnizimi me ujë dhe kanalizime të ujërave të përdorura në Lezhë dhe Shëngjin, programi i infrastrukturës bashkiake I”.....	2731
Vendim i KM nr. 251, datë 12.4.2012	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Kfw Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II (fondet e grantit IPA 2009 dhe 2010), furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës”..	2741
Urdhër i MD nr. 195, datë 9.5.2012	Për rishpërndarjen sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve të caktuar në vitin 2011 dhe shpalljen e vendeve vakant.....	2763

VENDIM
Nr. 250, datë 12.4.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR KONTRIBUTIN ZVICERAN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË LEZHË DHE SHËNGJIN, PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për kontributin zviceran për financimin e projektit “Furnizimi me ujë dhe kanalizime të ujërave të përdorura në Lezhë dhe Shëngjin, programi i infrastrukturës bashkiake I”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJA E FINANCIMIT
PËR KONTRIBUTIN E PROJEKTIT ZVICERAN NDËRMJET
KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI),
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, TIRANË, PËR 10,000,000 EURO
(Kontributi i projektit zviceran për projektin e Lezhës financuar nga SECO) “Projekti i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për Lezhën dhe Shëngjinin”

Programi i infrastrukturës bashkiake I, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Fierit, Gjirokastrës, Lezhës dhe Sarandës (programi)

Mbi bazën e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 11 tetor 2011, për dhënien e asistencës financiare për projektin “Furnizimi me ujë dhe kanalizimet Lezhë dhe Shëngjin” (marrëveshja e projektit) dhe mbi bazën e marrëveshjes së datës [për t’u plotësuar] ndërmjet Sekretarit të Shtetit të Çështjeve Ekonomike të Konfederatës Zvicerane (SECO) dhe KfW-së (marrëveshja administrative), marrësi dhe KfW nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme të financimit. Për programin e infrastrukturës bashkiake I, jepet nga KfW një hua në shumën prej 16 milionë eurosh (hua) në përputhje me marrëveshjen e huas (marrëveshja e huas) dhe një kontribut tjetër financiar nga Komisioni Europian në shumën prej 4,621,500 eurosh dhe një kontribut financiar shtesë në shumën prej 490,000 eurosh jepet nga KfW në përputhje me marrëveshjen e financimit (marrëveshja e financimit) dhe një marrëveshje plotësuese financimi (marrëveshja plotësuese e financimit).

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do t’i japë marrësit një kontribut financiar që nuk i tejkalon 10,000,000 euro (me fjalë: dhjetë milionë euro) (kontributi i projektit zviceran).

Ky kontribut i projektit zviceran nuk do të shlyhet, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi do ta kanalizojë kontributin e projektit zviceran te shoqëria komunale UK Lezhë



(agjencia e ekzekutimit të projektit) në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të veprjë si njësi e implementimit të programit (njësia e implementimit të programit) për shërbimet e konsulencës. Marrësi do të bëjë që agjencia e ekzekutimit të projektit të përdorë kontributin e projektit zviceran për implementimin e programit të infrastrukturës bashkiake I (programi) në vendndodhjen Lezhë (projekti Lezhë i financuar nga SECO). Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit që vepron si njësi e implementimit të programit (njësia e implementimit të programit), shoqëria komunale UK Lezhë (agjencia e ekzekutimit të projektit) dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit të financuar nga SECO, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi i projektit zviceran në një shtesë të marrëveshjes së veçantë, për të cilën duhet të bihet dakord nga marrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të përballohen nga marrësi, njësi e implementimit të programit ose agjencia e ekzekutimit të projektit dhe tatimet e importit, si dhe detyrimet doganore nuk duhet të financohen nga kontributi i projektit zviceran.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit të projektit zviceran tek agjencia e ekzekutimit të projektit

2.1 Marrësi do ta kanalizojë kontributin e projektit zviceran të shprehur në euro tek agjencia e ekzekutimit të projektit si grand i pashlyeshëm, sipas marrëveshjeve të veçanta financiare.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi i projektit zviceran, marrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit të projektit zviceran nuk do të përbëjë ndonjë detyrim të agjencisë së ekzekutimit të projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje zvicerane.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW do ta disbursojë kontributin zviceran në përputhje me progresin e projektit të Lezhës financuar nga SECO dhe me kërkesën e njësisë së implementimit të programit. Me marrëveshjen e veçantë, marrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave, agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që tregojnë se fondet e kërkuara po përdoren për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW do të ketë të drejtën që të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2016.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW nuk mund të pezullojë disbursimet përveç kur:

- a) Marrësi nuk arrin t'i kryejë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur kërkohen;
- b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së huas të datës 23 dhjetor 2010 ose sipas marrëveshjes së financimit të datës 23 dhjetor 2010, ose sipas marrëveshjes plotësuese të financimit të datës [për t'u plotësuar] për këtë program ose për projektin e Lezhës financuar nga SECO, ose sipas marrëveshjeve të veçanta të përfaqësuara nga Ministria e Financave, që u përkasin njëres prej këtyre marrëveshjeve;
- c) Marrësi ose ndonjë agjenci e ekzekutimit të projektit nuk është në gjendje që të provojë se shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar; ose
- d) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë rëndë implementimin, operimin ose qëllimin e programit ose projektin e Lezhës të financuar nga SECO.

4.2 Në qoftë se ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 4.1 "b" ose "c" ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW, e cila, sidoqoftë do të jetë të paktën 30 ditë, KfW:

a) në rastin e nenit 4.1 “b”, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 4.1 “c”, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave që marrësi ose ndonjë agjenci e ekzekutimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi do t’i përballojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që rrjedhin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për sa i përket lidhjes dhe ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje, si dhe kostot e transferimit dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit të projektit zviceran.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe prokura e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona të emëruar prej saj ose tij te KfW dhe të autorizuar me nënshkrime specimene të vërtetuara prej saj ose tij do të përfaqësojnë marrësin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori i përgjithshëm i agjencisë së ekzekutimit të projektit dhe ata persona të emëruar prej saj ose tij në KfW dhe të autorizuar me nënshkrime specimene të vërtetuara prej saj ose tij do të përfaqësojnë agjencinë përkatëse të ekzekutimit të projektit në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Prokurat e përfaqësimit nuk do të skadojnë deri në revokimin të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i marrësit të autorizuar në kohën që është marrë nga KfW.

6.2 Amendimet ose shtesat në këtë marrëveshje dhe çdo njoftim a deklaratë e dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë do të merret sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës korresponduese kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës korresponduese kontraktuese, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW: KfW
Department: L3a4 – Municipal Infrastructure
Southeast Europe and Turkey
Palmengartenstrasse 5 – 9
60325 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +4969 7431-2944

Për marrësin: Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Tel.: +355-4-2228405
Faks: +355-4-222 84 94

6.3 Amendimet e kësaj marrëveshjeje financimi që ndikojnë vetëm në marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe marrësit nuk do të kërkojnë pëlqimin e agjencisë së ekzekutimit të projektit.

Neni 7

Projekti i Lezhës i financuar nga SECO

7.1 Marrësi, i përfaqësuar nga njësia e implementimit të programit, do të bëjë vetë ose do të bëjë që agjencia e ekzekutimit të projektit:

a) të përgatisë, të zbatojë, të vërë në punë dhe të mirëmbajë programin në përputhje me praktikat e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e programit, siç është rënë dakord ndërmjet njësisë së implementimit të programit, agjencisë së ekzekutimit të projektit dhe KfW-së;



b) t'ia caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të nënprojekteve inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e nënprojektit firmave të kualifikuara;

c) të japë kontratat për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi i projektit zviceran me ofertim konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) të sigurojë financimin e plotë të programit dhe t'i japë KfW-së me kërkesën e saj prova që vërtetojnë se janë mbuluar kostot e papaguara nga ky kontribut i projektit zviceran;

e) të mbajë regjistra dhe të dhëna që tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për programin dhe të identifikojë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi i projektit zviceran;

f) t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë që të inspektojnë regjistrat dhe të dhënat e lartpërmendura dhe çdo e të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin dhe vënien në punë të programit dhe të vizitojnë programin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

g) t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe të dhënat për programin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së;

h) ta informojnë vullnetarisht menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon rëndë zbatimin, vënien në punë ose qëllimin e programit.

7.2 Marrësi i përfaqësuar nga njësia e implementimit të programit dhe KfW do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 7.1 me një shtesë në marrëveshjen e veçantë, për të cilën duhet të bihet dakord nga huamarrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi do të sigurojë vetë ose do të bëjë që agjencia e ekzekutimit të projektit të sigurojë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e çdo kontrate për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe me disbursimin e kërkuar të shumave të kontributit të projektit zviceran, të mos kërkojnë, marrin përsipër, bëjnë, japin, premtojnë apo marrin ndonjë premtim për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Në qoftë se ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje financimi për kontributin e projektit zviceran është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të paprekura prej saj. Çdo boshllëk që krijohet prej saj do të plotësohet me një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje financimi për kontributin e projektit zviceran.

8.3 Marrësi nuk mund të caktojë ose të transferojë, të premtojë apo të lërë peng ndonjë pretendim nga kjo marrëveshje financimi për kontributin e projektit zviceran.

8.4 Marrëveshja e financimit për kontributin e projektit zviceran do të rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo marrëveshje financimi për kontributin e projektit zviceran ndërmjet KfW-së dhe marrësit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes së vlefshme të projektit "Lezha" financiar nga SECO, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.6 Marrëveshja e financimit të kontributit të projektit zviceran do të hyjë në fuqi me plotësimin e procedurave ligjore të brendshme nga marrësi. Marrësi do ta informojë KfW-në menjëherë pas plotësimit të procedurave ligjore të brendshme.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main [për t'u plotësuar]

KfW

Nga:

Emri:

Titulli:

Tiranë [për t'u plotësuar]

Nga:

Emri:

Titulli:

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga:

Emri: Ridvan Bode

Titulli: Ministër i Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Sheshi “Skënderbej”, nr. 5 Tiranë Shqipëri	Corinna Engel Referenca: Eng Tel. +49 69 7431 2594 Faks. +49 69 7431 2547 E-mail: corinna.engel@kfw.de Datë: (të plotësohet)
--	---

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Programi “Infrastruktura bashkiake I”, 16 milionë euro (huaja)

BMZ - nr. 2009 66 523

Euro 4 621 500 (kontributi financiar) BMZ - nr. 2020 59 988

Euro 490 000 (kontributi financiar shtesë) BMZ - nr. 2020 60 408

Euro 10 milionë (kontributi i projektit zviceran), BMZ - nr. 2020 50 804

Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas dhe të programit të datës 23 dhjetor 2010 e për marrëveshjen e financimit mbi kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian të datës 23 dhjetor 2010, për marrëveshjen e financimit shtesë të dhënë nga Bashkimi Europian (IPA 2010) të datës (të plotësohet) dhe të marrëveshjes së financimit për kontributin e projektit zviceran nga SECO të datës (të plotësohet).

Këtu: Shtesë nr. 1 e marrëveshjes së veçantë të datës 23 dhjetor 2010

Të dashur zotërinj,

Ne i referohemi marrëveshjes së veçantë të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë – të përfaqësuar nga Ministria e Financave – (huamarrësi, përfituesi), Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (njësia e zbatimit të programit) dhe KfW-së (KfW), më 23 dhjetor 2010 në lidhje me zbatimin e programit “Infrastruktura bashkiake I – Furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Lezhës, Gjirokastrës, Sarandës dhe Fierit” (programi).

Në sajë të dhënies së fondeve shtesë të grantit nga Komisioni i Bashkimit Europian nga IPA 2010, zbatimi i programit të infrastrukturës bashkiake I në vendndodhjet Sarandë dhe Lezhë mund të përfundojnë nëpërmjet financimit të caktimit të konsulentit institucional në shumën prej 490 000 eurosh.

Në sajë të dhënies së fondeve shtesë të grantit nga sekretariati i shtetit për çështjet ekonomike të Konfederatës Zvicerane (SECO) për projektin “Furnizimi me ujë dhe kanalizimet Lezhë dhe Shëngjin” (projekti i Lezhës i financuar nga SECO), programi i sipërpërmendur do të zgjerohet. Kjo bëhet mbi bazën e marrëveshjes së projektit ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 17 nëntor 2011 (të plotësohet) dhe mbi bazën e marrëveshjes së financimit mbi kontributin zviceran për projektin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së të datës (të plotësohet) për një financim grandit në shumën prej 10 000 000 eurosh, si fonde të projektit për “Furnizimin me ujë dhe kanalizimet në Lezhë” (kontributi zviceran për projektin).

Sipas parashikimit në nenin IV 2.7, dispozitat në marrëveshjen e veçantë mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me pëlqimin e përbashkët nëse kjo duket e dobishme për zbatimin e programit ose për zbatimin e marrëveshjes së huas dhe programit.

SEKSIONI 1 MODIFIKIMET E MARRËVESHJES SË HUAS

Dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes së veçantë të datës 23 dhjetor 2010 modifikohen si më poshtë:

a) Faqja e parë

Titulli i faqes së parë zëvendësohet me sa më poshtë:

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë



Programi “Infrastruktura bashkiake I”, 16 milionë euro (huaja) BMZ - nr. 2009 66 523

Euro 4 621 500 (kontributi financiar) BMZ - nr. 2020 59 988

Euro 490 000 (kontributi financiar shtesë) BMZ - nr. 2020 60 408

Euro 10 milionë (kontributi i projektit zviceran), BMZ - nr. 2020 50 804

Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas dhe të programit të datës 23 dhjetor 2010 e për marrëveshjen e financimit mbi kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian të datës 23 dhjetor 2010, për marrëveshjen e financimit shtesë të dhënë nga Bashkimi Europian (IPA 2010) të datës (të plotësohet) dhe të marrëveshjes së financimit për kontributin e projektit zviceran nga SECO të datës (të plotësohet).

b) Neni I.1 “Hollësitë e programit”:

Në fund të paragrafit të dytë futet paragrafi i mëposhtëm:

“Dizenjoja e projektit të Lezhës e financuar nga SECO bazohet në “Studimin e parafizibilitetit për furnizimin me ujë dhe kanalizimet Lezhë dhe Shëngjin” nga konsulenti Wagner, të disponueshëm nga KfW-ja, huamarrësi, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, që vepron si njësi e zbatimit të programit (njësia e zbatimit të programit) dhe ndërmarrjeve të ujit (agjencitë e zbatimit të programit), dhe në marrëveshjet e lidhura nga KfW-ja, huamarrësi, njësia e zbatimit të programit dhe UK Lezha, gjatë programit lokal të parashikuar në protokollin e mbledhjes së datës 21 shtator 2010.”.

Në fund të nenit I.1, shtohen aktivitetet e mëposhtme të programit për Lezhën:

“ – Projekti i Lezhës i financuar nga SECO: Rehabilitimi i rrjetit të ujit të pijshëm, zgjerimi i rrjetit dhe lidhjet e reja, zëvendësimi i puseve dhe i rezervuarit, pajisjeve mekanike, mjeteve të rrjetit dhe të pajisjeve të zbulimit të rrjedhjeve.”.

c) Neni I.3 “Kostoja dhe financimi i plotë” zëvendësohet nga:

“Kostoja e parashikuar totale e programit (kostoja totale) që përfshin vlerësimin e programit është afërsisht 31.11 euro. Shuma e huas është 16 milionë euro për të financuar investimet në lidhje me koston e konsulencës në vendndodhjet e programit në Fier, Lezhë, Gjirokastër dhe Sarandë. Përveç kësaj, jepet një grand i BE-së (kontributi financiar) te zëri bashkiak i instrumentit të projektit për infrastrukturën (IPF-MË), prej 4 621 500 eurosh, i cili financon masat në Fier dhe Gjirokastër. Për më tepër, jepet një grand i BE-së (kontributi financiar shtesë) i dhënë nga IPA 2010, prej 490 000 eurosh, për të financuar shërbimet e konsulencës për fuqizimin institucional në Lezhë dhe Sarandë. Fondet e grandit në shumën prej 10 000 000 eurosh do të jepen nga SECO (kontributi zviceran për projektin) për të financuar masat shtesë dhe koston përkatëse të konsulencës në Lezhë. Përbërja e koston totale dhe plani i financimit gjenden tek anekset 3a dhe 3b”.

d) Neni II.4.4 “Marrëveshjet e veçanta të zbatimit”

Masat për Lezhën zëvendësohen nga:

“Lezha:

- Rritja e tarifës vjetore për ujin prej të paktën 15% për vitet 2010 deri 2012;
- Instalimi i 4000 matësve të ujit;
- Faturimi dhe marrëdhënie të përmirësuara me klientin.”.

e) Neni III.2 “Procedura e disbursimit”

Në fund të nenit III.2 shtohet sa më poshtë:

“Një përjashtim tjetër janë masat e financimit shtesë për projektin e Lezhës të financuar nga SECO (shih aneksin 3b) që paguhet vetëm nga kontributi i projektit zviceran.”.

SEKSIONI 2

VLEFSHMËRIA E VAZHDUAR E MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Të gjitha dispozitat e marrëveshjes së veçantë të datës 23 dhjetor 2010 mbeten të pandryshuara.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në një formë ligjrisht detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëngjitura.

Ne bashkëngjishim një kopje të kësaj letre me kërkesën për t'ua kaluar rregullisht bashkive të Lezhës dhe Sarandës.

Jeni të lutur t'i kaloni një kopje të kësaj letre rregullisht edhe konsulentit:

KfW

Nga: ---- Nga: ---

Emri: ---- Emri: ----

Titulli: ---- Titulli: ----

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, ----

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi)

Nga: ---

Emri: Ridvan Bode

Titulli: Ministër i Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Nga: ---

Emri: Sokol Oldashi

Titulli: Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

Ndërmarrja e Ujit, Lezhë Ndërmarrja e Ujit, Sarandë

Nga: ---- Nga: ---

Emri: ---- Emri: ----

Titulli: ---- Titulli: ----

Anekset

Aneksi 1a: Objektivat dhe rezultatet e programit dhe prezumimet për arritjen e projektit të Lezhës së financuar nga SECO;

Aneksi 3a: Kostoja dhe financimi total;

Aneksi 3b: Kostoja dhe financimi total i projektit të Lezhës së financuar nga SECO.

Projektshtesa përfundimtare nr. 1 e marrëveshjes së veçantë e datës 19 dhjetor 2011.

ANEKSI 1A GRAFIK PËR PROJEKTIN E LEZHËS SË FINANCUAR NGA SECO MATICË¹

Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kryesorë të performancës	Mjetet e verifikimit	Faktorë të jashtëm (prezumime/rreziqe)
Ndikimi	Tregues të performancës		
Kushte të përmirësuara jetese për popullatën dhe gjendje e favorshme kuadër për ekonominë lokale të Lezhës nëpërmjet rehabilitimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe disa masa emergjente të rehabilitimit të rrjetit të kanalizimeve	- Evoluimi i të ardhurave mesatare të ekonomive shtëpiake - Numri i industrive të reja dhe të bizneseve të themeluara në Lezhë	- Statistika bashkiake dhe të INSTAT-it - Sondazh i matjes së standardeve të jetesës (LSMS)	- Kushtet ekonomiko-sociale të popullatës nuk dobësohen - Çështjet e ujit mbahen jashtë luftës politike - Subvencionimi i koston O&M do të bëhet deri në zbatimin e tarifave të rikuperimit me kosto të plotë
Rezultatet	Treguesit e rezultateve		
1. I njëjti nivel shërbimi për furnizimin me ujë jepet për një	1.1 Numri i lidhjeve të reja (0/4 000)	- Raportet teknike dhe	- Kostoja e energjisë - Klientët pranojnë tarifa më

¹Grafiku përfshin gjithashtu komponentët e financuar nga huaja e KfW-së. Pa këto investime, rezultati dhe rezultatet e ndikimit nuk do të ishin të arritshme.



<p>numër më të madh klientësh në bashkinë e Lezhës, duke arritur nivelin prej 94% për popullatën urbane dhe 45% për popullatën rurale</p> <p>2. Furnizimi me ujë të pijshëm është i besueshëm dhe i vazhdueshëm me presionin e përshtatshëm për operimin e rrjetit</p> <p>3. Kostoja e ulët e operimit dhe e mirëmbajtjes dhe e përballeshme – duke përfshirë të varfrit – për koston e ujit të pijshëm dhe duke siguruar rikuperimin e koston dhe rritjen e aftësisë së bashkisë për të vazhduar me rehabilitimin e sistemit të ujit</p> <p>4. Përmirësohet cilësia e ujit</p> <p>5. Vendoset koncepti për të trajtuar situatën e pastrimit të Lezhës</p>	<p>1.2 Lidhja me sistemin qendror të furnizimit me ujë në zonën urbane (90%/94%)</p> <p>1.3 Lidhja me sistemin qendror të furnizimit me ujë në zonën rurale (30%/45%)</p> <p>2.1 Të gjithë klientët në qendër të qytetit kanë 24 orë ujë të pastër të pijshëm gjatë 330 ditëve të vitit (të ndryshme min 1, mak 4 bar)</p> <p>3.1 Tarifat nuk i kalojnë 5% të të ardhurave mesatare</p> <p>3.2 Klientët e kënaqur (2000/ < 1000 ankesa/vit)</p> <p>3.3 Të ardhurat (subvencione) mbulojnë koston e operimit dhe mirëmbajtjes (58%/100%)</p> <p>3.4 Humbjet tregtare ulen (52%/40%).</p> <p>3.5 Rritja e ujit të faturuar bazuar në konsumin e matur (47%/90%)</p> <p>3.6 Mbledhja e rritur e të ardhurave (70%/80%)</p> <p>4.1 Cilësia e ujit përputhet me standardet e OBSH-së (70%/90%)</p> <p>5.1 Kryhet studimi i fizibilitetit duke përfshirë buxhetin</p>	<p>financiare të ndërmarrjes së ujit të Lezhës.</p> <p>- Protokollin nga mbledhjet e bordit mbikëqyrës dhe vendimi nga autoriteti rregullator</p> <p>- Të dhëna social-ekonomike</p>	<p>të larta</p> <p>- Klientët kanë vullnet për të paguar ose masat ligjore janë të suksesshme</p> <p>- Lidhjet e paligjshme hiqen ose legalizohen; zbatohet operimi eficient dhe mirëmbajtja parandaluese</p> <p>- Ndërmarrja e ujit të Lezhës ka numrin e kërkuar të personelit me arsimin dhe eksperiencën e mjaftueshme profesionale</p> <p>- Personel i mjaftueshëm për leximin, instalimin dhe mirëmbajtjen e matësve</p>
<p>Rezultati</p>	<p>Treguesit e rezultatit</p>		
<p>1. Komponentë të sistemit teknikisht operativë sipas specifikimit:</p> <p>a) pusi nr. 1 rindërtohet</p> <p>b) Kryhen lidhjet e reja (4000)</p> <p>c) Ndërtohen rezervuarë të rinj (Lezhë 2000 m³) dhe/ose rehabilitimi</p> <p>d) Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes së ujit në qendër të Lezhës, ndërtimi i rrjetit të</p>	<p>1. Masat e marra në lidhje me:</p> <p>- Planifikimin teknik</p> <p>- Grafiku kohor</p> <p>- Planifikimi i koston</p> <p>2. Programi i ri është funksional</p> <p>3. Grafikët e rinj përpilohen dhe i dorëzohen rregullatorit</p> <p>4. Konsumi i ujit për</p>	<p>1.a) – g) Raportet e progresit të projektit</p> <p>2. – 5. Konsulenti i raportit të progresit</p>	<p>Rezultati i tenderëve brenda gamës së parashikimit të koston</p> <p>Dhënia e subvencioneve deri në mbulimin e plotë të koston</p>

shpërndarjes në frutore dhe SMT (83 km) e) Ndërtimi i tubacionit të transmetimit (Baldren 5 km) f) Rehabilitimi i pjesëve të rrjetit të kanalizimeve (qendër e Lezhës) g) Instalimi i matësve shtëpiakë dhe të shumicës (4000) h) Sistemi SCADA, mjetet e rrjetit, pajisjet e mirëmbajtjes dhe të gjetjes së rrjedhjeve 2. Sistemi i ri i faturimit dhe llogarive 3. Përshtatjet e tarifave të qëndrueshme 4. Fushatë për uljen e humbjeve të ujit dhe konsumit të qëndrueshëm të ujit 5. Koncepti i zhvillimit të personelit 6. Koncepti i raportit me klientin 7. Studimi i fizibilitetit për pastrimin në Lezhë.	kokë ulet (240l/c/d2/110 l/c/d) 5. Zbatimi i konceptit të zhvillimit të personelit 6. Zbatimi i konceptit të raportit me klientin 7. Aprovimi i studimit të fizibilitetit		
---	--	--	--

**ANEKSI 3A
KOSTOJA DHE FINANCIMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE I**

Aneksi 3 zëvendësohet nga ky aneks 3a për rishikimin e mëposhtëm të kostos dhe të financimit duke përfshirë kontributin financiar shtesë nga fondet e grandit IPA 2010.

KOSTOJA DHE FINANCIMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE I

Rezultatet/masat e projektit	Kostoja	Huaja e KfW-së	Grandi i BE-së	
			IPA 2008 + 2009	IPA 2010
Lezhë				
Furnizimi me ujë	1, 460, 000	1, 460, 000		
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	940, 000	940, 000		
Pajisjet operacionale	250, 000	250, 000		
Shërbime konsulence, zbatim	345, 000	345, 000		
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	245, 000			245, 000
Fondi rezervë	105, 000	105, 000		
Totali, Lezhë	3, 345, 000	3, 100, 000		245 000
Gjirokastër				
Furnizimi me ujë	3, 036, 938	2, 005, 000	1, 031, 938	



Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	1, 946, 938	915, 000	1, 031, 938	
Pajisjet operacionale	130, 000	130, 000		
Shërbime konsulence, zbatimi	816, 500	816, 500		
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	246, 875		246, 875	
Fondi rezervë	133, 500	133, 500		
Totali, Gjirokastrë	6, 310, 751	4, 000, 000	2, 310, 751	
Saranda				
Furnizimi me ujë	2, 710, 000	2, 710, 000		
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	530, 000	530, 000		
Pajisjet operacionale	100, 000	100, 000		
Shërbime konsulence, zbatimi	566, 500	566, 500		
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	245, 000		245, 000	
Fondi rezervë	93, 500	93, 500		
Totali, Saranda	4, 245, 000	4, 000, 000	245, 000	
Fier				
Furnizimi me ujë	4, 323, 875	2, 260, 000		
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	1, 450, 000	1, 450, 000		
Pajisjet operacionale	290, 000	290, 000	2, 063, 875	
Shërbime konsulence, zbatimi	765, 500	765, 500		
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	246, 875		246, 875	
Fondi rezervë	134,500	134,500		
Totali, Fier	7, 210, 750	4, 900, 000	2, 310, 750	
Faza e parë e plotë e investimeve	21, 111, 501	16, 000, 000	4, 621, 501	490, 000

ANEKSI 3B
KOSTOJA DHE FINANCIMI PËR PROJEKTIN E LEZHËS FINANCIAR NGA SECO

Furnizimi me ujë	Euro
Rehabilitimi i rrjetit të ujit të pijshëm në qendrën e qytetit të Lezhës (afërsisht 83 km dhe 6000 lidhje)	6, 640, 000
Zgjerim i rrjetit në zonat e SMT-së dhe frutores duke përfshirë lidhjet e reja (afërsisht 4 000)	360, 000
Zëvendësimi i pusit në Barbullojë	220, 000
Zëvendësimi i rezervuarit	400, 000
Pajisje mekanike, mjete rrjeti, pajisje për gjetjen e rrjedhjeve	150, 000
Masat për kanalizimet	

Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve në qendrën e qytetit të Lezhës	500, 000
Shërbime konsulence	
Konsulenti i planifikimit dhe i zbatimit	600, 000
Studimi i fizibilitetit, Lezhë	350, 000
Fondi rezervë (10% e investimit)	780, 000
Investimi i plotë	10, 000, 000

Shënim. Buxheti është vetëm tregues. Shmangiet ndërmjet zërave mund të bëhen pa ndryshuar marrëveshjen, për sa kohë këto janë brenda kufirit 25%.

VENDIM
Nr. 251, datë 12.4.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II (FONDET E GRANDIT IPA 2009 DHE 2010), FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET E BERATIT, FIERIT, KAMZËS, KUÇOVËS, LUSHNJËS DHE SARANDËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II (Fondet e grandit IPA 2009 dhe 2010), furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KFW-SË, FRANKFURT MBI MAIN (KFW)
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, TIRANË
(PËRFITUESI), PËR 20 482 000 EURO (FONDET E GRANDIT IPA 2009 DHE 2010)
Programi II i infrastrukturës bashkiake furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (programi)

Mbi bazën e marrëveshjes së kontributit të datës 29 nëntor 2010 ndërmjet Komisionit Europian, Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës dhe KfW-së (marrëveshja e kontributit) dhe mbi bazën e një marrëveshjeje delegimi të datës 30 qershor 2011 ndërmjet Komisionit Europian dhe KfW-së (marrëveshja e delegimit), përfituesi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të financimit. Një hua tjetër në shumën 12 milionë euro (huaja A) dhe një hua tjetër në shumën prej 2 milionë eurosh (kontributi financiar) do të jepen nga KfW-ja në pajtim me një marrëveshje huaje (marrëveshja e huas A) dhe një marrëveshje tjetër huaje (marrëveshje huaje B) ndërmjet KfW-së dhe përfituesit.



Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë përfituesit një kontribut financiar që nuk kalon 20 482 000 euro (në fjalë: njëzet milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë euro)(kontributi financiar).

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2

1.2 Përfituesi e kanalizon kontributin financiar plotësisht te shoqëritë UK Berat-Kuçovë, UK Fier, UK Lushnjë, UK Sarandë dhe te departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës (së bashku "Agjencitë e zbatimit të projektit", secila një "Agjenci e zbatimit të projektit") në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të veprojë si njësi e zbatimit të projektit (njësia e zbatimit të programit) për konsulentin e zbatimit. Përfituesi merr masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit të përdorë kontributin financiar vetëm për financimin e investimeve për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe sistemet e kanalizimeve në qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (secila një "nënprojekt", së bashku "programi"). Njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar në një marrëveshje të veçantë, e cila duhet të miratohet nga përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Tatimet dhe taksat e tjera publike për të cilat detyrohet përfituesi, njësia e zbatimit të programit dhe secila prej agjencive të zbatimit të projektit, si dhe detyrimet e importit dhe detyrimet doganore nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar tek agjencitë e zbatimit të projektit

2.1 Përfituesi e kanalizon kontributin financiar të përcaktuar në euro tek agjencitë e zbatimit të projektit sipas marrëveshjeve të nënhuas, si një grand i pashlyeshëm në bazë të marrëveshjeve të nënfinancimit.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, përfituesi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk përbën përgjegjësi të ndonjë agjencie të zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje financimi.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson kontributin financiar në pajtim me progresin e programit, me kërkesë të agjencive të zbatimit të projektit. Në një marrëveshje të veçantë që duhet të bihet dakord ndërmjet përfituesit, përfaqësuar nga Ministria e Financave, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja, përcaktohet procedura e disbursimit, duke përfshirë veçanërisht provat që provojnë se fondet e disbursuara përdoren për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë bërjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2015.

Neni 4

Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) përfituesi nuk ka përbushur detyrimet e veta ndaj KfW-së sipas programit të infrastrukturës bashkiake II për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje financimi, sipas marrëveshjes së huas A dhe B të datës (të plotësohet) për këtë program ose sipas marrëveshjeve të veçanta në lidhje me një prej këtyre marrëveshjeve, janë shkelur;

c) përfituesi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se shumat e huas janë përdorur për qëllimet e parashikuara; ose

d) linden rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit.

4.2 Nëse ka ndodhur një nga situatat e specifikuar në nenin 4.1 “b” ose “c” dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastet e specifikuar në nenin 4.1 “b”, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1 “c”, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave meqë përfituesi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se është përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5

Kostoja dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet publike që rrjedhin jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje financimi, si dhe koston e transferimit dhe konvertimit që shkaktohet në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklarimet kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, e përfaqësojnë përfituesin në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje financimi. Drejtori i përgjithshëm i çdo agjencie të zbatimit të projektit dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë përfituesin në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje financimi. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i përfituesit të autorizuar për atë kohë të jetë marrë prej KfW-së.

6.2 Ndryshimet ose shtojcat e kësaj marrëveshjeje financimi dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jetë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaram i tillë konsiderohet i marrë menjëherë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës përkatëse kontraktuese ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese që njoftohet nga pala tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW

Departament: LEa4-Municipal Infrastructure

South East Europe and Turkey

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany

Faks: +49 69 7431 2944

Për përfituesin: Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë

Shqipëri

Faks: (+355) 4 222 8494

6.3 Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje financimi cenojnë vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe përfituesit dhe nuk kërkojnë pëlqimin e agjencive të zbatimit të projektit.



Neni 7 Programi

7.1 Përfituesi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit, merr masa vetë dhe merr gjithashtu masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit:

a) të përgatisë, të zbatojë, të operojë dhe të ruajë programin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet njësisë së zbatimit të programit, agjencive të zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për nënprojektet konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e nënprojekteve firmave të kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga kontributi financiar me tender konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) siguron financim të plotë të programit dhe i jep KfW-së, me kërkesë të saj, prova që provojnë se kostoja e papaguar nga kontributi financiar është mbuluar;

e) mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) mundëson që përfaqësuesit e KfW-së, Komisionit Europian, OLAF-it (Zyra europiane kundër mashtrimit), Gjykatës Europiane të Auditëve dhe çdo organi kompetent të Komunitetit Europian, Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës dhe/ose delegacionit të Komisionit Europian në Shqipëri, të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe operimin e programit dhe për të vizituar programin dhe instalimet në lidhje me të;

g) i jep KfW-së ose me kërkesë, Komisionit Europian, OLAF-it, Gjykatës Europiane të Auditëve dhe çdo organi kompetent të Komunitetit Europian dhe merr masa që çdo informacion i tillë dhe regjistrat e programit dhe progresit të tij të mëtejshëm t'i jepet KfW-së ose të përmendurve më sipër, sipas kërkesës. Përfituesi njihet të drejtën e Komisionit Europian, OLAF-it, Gjykatës Europiane të Auditëve dhe çdo organi kompetent të Komunitetit Europian të përdorë falas, si ta çmojnë të përshtatshme, të gjitha dokumentet që janë financuar nga ky kontribut financiar;

h) siguron që të gjitha publikimet ose informacioni promociional mbi projektin të përfshijnë një referencë të faktit që programi është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës dhe të shfaqë logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdha në një sfond blu);

i) lejon për vizita vlerësimi dhe monitorimi përfaqësuesit e Komisionit Europian, OLAF-it, Gjykatës Europiane të Auditëve dhe organeve të tjera kompetente të Komunitetit Europian në njësinë e zbatimit të programit ose çdo agjenci e zbatimit të projektit;

j) siguron që, për një periudhë deri shtatë vjet pas përfundimit të projektit, Komisioni Europian, OLAF-i, Gjykata Europiane e Auditëve dhe organet e tjera kompetente të Komunitetit Europian të jenë në gjendje të kryejnë auditet e nevojshme për të verifikuar përdorimin e kontributit financiar, mbi bazën e dokumenteve dhe në terren, duke përfshirë të gjitha kontratat dhe nënkontratat që janë financuar nga kontributi financiar. Komisioni Europian, OLAF-i dhe Gjykata Europiane e Auditëve kanë të drejtën të dërgojnë agjentët e tyre për të kryer në terren kontrolle dhe inspektime sipas parashikimit të rregullores (EC, Euratom) nr. 2185/1996; dhe

k) menjëherë dhe me pëlqimin e tij, njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit.

7.2 Përfituesi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit dhe KfW-ja, përcaktojnë hollësitë e nenit 7.1 me një marrëveshje të veçantë, e cila duhet të miratohet nga përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

7.3 Përfituesi dhe njësia e zbatimit të programit asistojnë agjencitë e zbatimit të projektit, në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike në zbatimin e programit dhe përmbushjen e detyrimeve të agjencive të zbatimit të projektit sipas marrëveshjes së financimit dhe, veçanërisht, u japin agjencive të zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e programit.

Neni 8
Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi siguron vetë dhe merr masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit siguron që personat e ngarkuar prej tyre me përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e një kontrate për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar, të mos kërkojnë, marrin, paraqesin, ofrojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje financimi është ose bëhet e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh nga kjo plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

8.3 Përfituesi nuk mund të kalojë, të transferojë, të rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo marrëveshje financimi.

8.4 Kjo marrëveshje financimi rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurt mbi Main.

8.5 Të gjitha marrëdhëniet që vendosen nga kjo marrëveshje financimi ndërmjet KfW-së dhe përfituesit pushojnë së qeni në fuqi me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të programit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje financimi.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main, (të plotësohet)

KfW

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Tiranë, (të plotësohet)

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Ridvan Bode

Ministër i Financave

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Sheshi "Skënderbe" nr. 5 Tiranë Shqipëri	Corinna Engel Referenca jonë: Eng Tel. +49 (0) 69 7431 2594 E-mail: corinna.engel@kfw.de Datë: (të plotësohet)
--	--

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Programi "Infrastruktura bashkiake II",

12 milionë euro (huaja A)

BMZ - nr. 2010 65 705

2 milionë euro (huaja B)

BMZ - nr. 2010 66 315

20, 482, 000 euro (kontributi financiar)

BMZ - nr. 2020 60 408 dhe BMZ - nr. 2020 60 242

Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas A të datës _____ (të plotësohet), për marrëveshjen e huas B të datës _____ (të plotësohet) dhe për marrëveshjen e financimit mbi kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian të datës _____ (të plotësohet).

Projekti përfundimtar i datës 19 dhjetor 2011.

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi programit të infrastrukturës bashkiake II të KfW-së për furnizimin me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, të Fierit, të Kamzës, të Kuçovës, të Lushnjës dhe të Sarandës (programi) dhe marrëveshjes përkatëse të huas të datës (të plotësohet) (marrëveshja e huas A) prej 12 milionë eurosh (Huaja A), marrëveshjes së huas të datës (të plotësohet) (marrëveshja e huas B) prej 2



milionë eurosh (Huaja B) ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe marrëveshjes së financimit prej 20, 482, 000 eurosh të lidhur ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (përfituesi) (të plotësohet).

Marrëveshjet e sipërpërmendura janë të njohura për secilën prej UK Berat-Kuçovë, UK Fier, departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës, UK Lushnjë dhe UK Sarandë që veprojnë si agjenci për zbatimin e projektit (së bashku “agjencitë e zbatimit të projektit”, secila “agjenci e zbatimit të projektit”, PEA) të programit dhe zbatimin e tij në çdo qytet përkatës (secili “nënprojekt”). Secila prej agjencive të zbatimit të projektit bie dakord për marrëveshjen e sipërpërmendur të huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit dhe në veçanti e njeh rolin e saj si agjenci e zbatimit të projektit në lidhje me nënprojektin dhe bie dakord të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse dhe të përmbushë rregullisht të gjitha detyrimet sipas marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjes së financimit në lidhje me programin, siç specifikohet më tej në marrëveshjen e huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit, siç specifikohet këtu më tej. Në pajtim me marrëveshjen e huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 të marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit:

Hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.4 të marrëveshjes së huas A, nenin 3.1 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 2.1 të marrëveshjes së financimit:

Procedurën e disbursimit, veçanërisht të dhënat që provojnë se shumata e disbursuara të huas janë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

Në pajtim me nenin 11.2 të marrëveshjes së huas A, nenin 8.2 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 7.2 të marrëveshjes së financimit:

Hollësitë që u përkasin neneve të sipërpërmendura në lidhje me zbatimin e programit dhe informacionin e veçantë.

Ne propozojmë të bihet dakord sa më poshtë:

I. Projektimi i programit

1. Hollësitë e programit

Programi ka të bëjë me përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në bashki të zgjedhura të Shqipërisë, që janë bashkitë e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës. Ky program i infrastrukturës bashkiake II pason programin e infrastrukturës bashkiake I të KfW-së. Qëllimi i programit është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe higjienikisht të sigurt për popullatën e qyteteve të programit me mbulim të shpenzimeve dhe tarifa shoqërisht të mbulueshme, si dhe të sigurojë higjienë të përshtatshme nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza. Kjo do të kontribuojë për një përdorim të efektshëm të burimeve ujore dhe për mbrojtjen e mjedisit me përmirësim paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetit të popullsisë. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e kërkuara të programit, si dhe supozimet në mbështetje të qëllimit të programit dhe rezultatet e programit gjenden në aneksin 1.

Projektimi i programit bazohet në analizën institucionale të *MACS GmbH* të datës qershor 2010 dhe studimet e parafizibilitetit nga *Kocks consult* dhe *White Young Green Consult* të datës tetor 2011 në dispozicion të KfW-së, huamarrësit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, që vepron si njësi e zbatimit të programit (“njësia e zbatimit të programit”, PIU) dhe ndërmarrjeve të ujit dhe përkatësisht departamentit të ujit të Kamzës (agjencitë e zbatimit të programit) dhe në marrëveshjet ndërmjet KfW-së, huamarrësit, njësisë së zbatimit të programit dhe agjencive të zbatimit të programit gjatë vlerësimit të programit lokal në nëntor/dhjetor 2010, të përcaktuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 2 dhjetor 2010.

Aktivitetet e mëposhtme të programit financohen nga huaja A dhe B dhe/ose kontributi financiar:

Berati dhe Kuçova:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit;

- Zëvendësimi i pjesshëm i tubacionit të transmetimit nga Bugova në Berat dhe zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në fshatra;
- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në qendër të Beratit dhe në Kuçovë;
- Ndërtimi i tubacionit të transmetimit nga rezervuari i Koksit në rezervuarin e Drizës;
- Pajisjet operationale (kalibrimi i matësve të ujit etj.);
- Lidhjet e reja të fshatrave me rezervuarin e Drizës;
- Rrethimi i impiantit të trajtimit të ardhshëm të ujërave të zeza (WWTP);
- Ndërtesa e operacioneve.

Fieri:

- Lidhja e Levanit dhe Frakullit nëpërmjet tubacionit të veçantë të transmetimit, duke përfshirë kapacitetin shtesë të rezervuarit dhe pompat e reja të pusit;
- Rrethimi në të ardhmen i zonës WWTP;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve në qendër të qytetit dhe/ose zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve në zonat perëndimore, në varësi të rezultateve të inspektimit CCTV;

Kamza:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit për ekonomitë shtëpiake;
- Tubacioni i transmetimit (nga rezervuari i ujit WTP);
- Impianti i trajtimit të ujit;
- Rezervuari;
- Rrjeti i shpërndarjes, instalimi i lidhjeve të reja;
- Pajisja operationale për shkarkimin e ujit dhe kanalizimet (identifikimi i humbjeve etj.).

Lushnja:

- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në zonën e qytetit;
- Matësit shtesë të ujit;
- Rrethimi i zonës së WWTP-së në të ardhmen;
- Pajisjet operationale;
- Ndërtesa e operacioneve, duke përfshirë ruajtjen dhe punishtet.

Saranda:

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjeteve të shpërndarjes së ujit në Sarandë;
- Pajisjet operationale të matësve të ujit me shumicë, duke përfshirë ndërtesën operationale të jashtme.

2. Grafiku kohor

Grafiku përkatës kohor për përgatitjen, për zbatimin dhe për operimin e programit gjendet në aneksin 2.

3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e llogaritur e programit (kostoja totale) që mbështet vlerësimin e programit është rreth 34.5 milionë euro. Shuma e huas është 12 milionë euro për huan A dhe 2 milionë euro për huan B për të financuar investimet në vendndodhjet e programit në Berat, Fier, Kamëz, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë. Përveç kësaj, ka edhe një grand të BE-së (kontributi financiar) në shumën totale prej 20.482.000 eurosh. Parashikohet nën instrumentin e paraaderimit 2009 (IPA 2009) prej 5.39 milionë eurosh dhe sipas IPA 2010 prej 15.092 milionë eurosh që ndërmjet zërave të tjerë do të përfshijë veçanërisht shërbimet e konsulencës. Përbërja e koston totale dhe plani i financimit gjenden në aneksin 3.

4. Ndryshimet në projektimin e programit

Çdo ndryshim thelbësor në projektimin e programit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe të huamarrësit/përfituesit. Njësia e zbatimit të programit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit njoftojnë menjëherë për këtë KfW-në, duke përcaktuar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë koston totale). Ekzekutimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

Studimi i fizibilitetit që duhet të përditësohet kërkon pëlqimin e ndërsjellët të KfW-së, PIU-së dhe bashkisë së Kamzës para disbursimit të parë për nënprojektin e Kamzës.



II. Zbatimi i programit

1. Përgjegjësitë dhe grafiku i kohës, kostos dhe financimit

1.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për zbatimin e programit. Brenda këtij institucioni do të emërohet personeli në Drejtorinë e Përgjithshme për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (GDWSS) për të formuar njësinë e zbatimit të programit (PIU). Ndërmarrjet e ujit pjesërisht në pronësi të bashkimeve përkatëse janë përgjegjëse për zbatimin dhe operimin e nënprojekteve të veçanta nën mbikëqyrjen e PIU-së. Të gjitha palët bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programit dhe përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët aspektet e programit që janë thelbësore për operimin e tij.

1.2 Grafiku i detajuar i kohës, kostos dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të programit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga njësinë e zbatimit të programit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen kronologjike të aktiviteteve të programit dhe kërkesat financiare rezultuese. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të programit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, ndërmarrjet e ujit të Berat-Kuçovës, të Fierit, të Lushnjës dhe të Sarandës dhe departamenti i ujit në bashkinë e Kamzës me asistencën e konsulentit të zbatimit (konsulenti i zbatimit) do të kryejnë një projektim të hollësishëm, do të përpilojnë dokumentet e tenderit dhe do të prokurojnë mallrat dhe shërbimet. Konsulenti i zbatimit asiston ndërmarrjet e ujit në mbikëqyrjen e punëve të ndërtimit dhe periudhën e përgjegjësisë për defektet. Konsulenti i zbatimit kontraktohet nga njësinë e zbatimit të programit. Në rast se shuma e kontratës së konsulentit kalon në nivel të konsiderueshëm buxhetin sipas aneksit 3, huamarrësi duhet të aprovojë buxhetin e rishikuar.

2.2 Për masat institucionale në Lushnjë, në Kamëz dhe në Sarandë angazhohet një konsulent institucional (konsulent institucional) për të mbështetur ndërmarrjet në uljen e humbjeve administrative dhe në rishikimin e tarifave dhe planeve të biznesit për të përmirësuar situatën e tyre të të ardhurave në mënyrë të konsiderueshme (për t'u financuar nga kontributi financiar). Ky konsulent institucional do të kontraktohet nga njësinë e zbatimit të programit.

2.3 Pas parapërzgjedhjes dhe ofertimit konkurrues ndërkombëtar publik, detyrat (për konsulentin e zbatimit dhe konsulentin institucional) jepen në kontrata të veçanta për shoqëritë e pavarura të kualifikuara konsulente. Procedura për dhënien e kontratës rregullohet nga "Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 4) që përbën pjesë integrale të kësaj. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

2.4 Në njoftimin e parakualifikimit ose, nëse nuk kryhet parakualifikim, në ftesën për tender, njësinë e zbatimit të programit i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e tenderit ose së bashku me ofertën, një deklaratë angazhimi të nënshkruar sipas rregullave (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Njësinë e zbatimit të programit i kërkon KfW-së të autorizojë një ekspert (Agjent tenderi) të asistojë njësinë e zbatimit të programit në zgjedhjen dhe kontraktimin e konsulentit të zbatimit dhe konsulentin institucional. Specifikisht, agjenti i tenderit asiston njësinë e zbatimit të programit me shërbimet e mëposhtme:

- Hartimin e termave të referencës për shërbimet e konsulencës, duke përfshirë një projekt kontratë konsulence (kontratë standarde konsulence e KfW-së);
- Përbushjen e parakualifikimit dhe "renditjen paraprake" për ofertuesit e kualifikuar;
- Kryerjen e tenderit, duke përfshirë propozimin e arsyetuar për dhënien e kontratës;
- Paraqitjen e një projektkontrate konsulence që është negociuar me konsulentët.

Kostoja e shkaktuar për agjentin e tenderit mbulohet nga një grand i veçantë që jepet për këtë qëllim nga Ministria Federale Gjermane për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (BMZ).

2.6 Brenda dy javëve pasi njësinë e zbatimit të programit dhe KfW-ja të kenë marrë propozimet e

agjentit të tenderit në lidhje me termat e referencës, propozimet dhe dhënien e kontratave dhe projektkontratave të konsulentëve, ata do t'i komentojnë ato.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera do të jepen në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për koment në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaramë që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet të tjerave, do t'i nënshtrohen verifikimit të Bashkimit Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

3.3 Periudha e ofertimit përcaktohet në një mënyrë të tillë që t'u mundësojë ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e mbetura në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale janë të shpjeguara tek "Udhëzimet për prokurimin e furnizimit dhe kontratat e punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5), që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit ose nëse nuk kryhet parakualifikimi, në dokumentet e tenderit, agjencitë e zbatimit të programit ose njësisia e zbatimit të programit në rastin e shërbimeve të konsulentëve, përkatësisht i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë angazhimi (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Gjatë lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja, agjencitë e zbatimit të programit respektojnë gjithashtu parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse nga huaja nuk mund të financohen detyrimet e importit në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas, këto detyrime importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, përcaktohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për shërbimet dhe mallrat duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikon që çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e kërkueshme dhe çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të huamarrësit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 3800 0000 00) të KfW-ja, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja i krediton këto pagesa në llogarinë e huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen te një llogari e veçantë e agjencisë së zbatimit të programit, në vendin e agjencisë së zbatimit të programit, që mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për ekzekutimin e programit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i jepet për koment projektkontrata e rënë dakord, e pajisur rregullisht me miratimin e konsulentit të zbatimit. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje pasuese modifikuese ose ndryshuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Para kontraktimit të shërbimeve të konsulentit të zbatimit, detyrat e mëposhtme duhet të përmbushen nga ndërmarrjet e ujit: Një koncept për përshtatjen e tarifave dhe mbulimin e shpenzimeve zhvillohet ose përditësohet përkatësisht dhe aprovohet nga bordi mbikëqyrës i ndërmarrjeve të ujit dhe i paraqitet rregullatorit (ERRU).

4.2 Para tenderimit të mallrave dhe shërbimeve të tjera, një audit i jashtëm ka certifikuar që UK Berat-Kuçovë ka arritur 80% të mbulimit të kostos, duke përfshirë shërbimin e borxhit, UK Fier ka arritur 90% të mbulimit të kostos, duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit të matësve të jashtëm të ujit), departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës ka arritur 55% të mbulimit të kostos, UK Lushnjë ka arritur 65% të mbulimit të kostos dhe UK Sarandë ka arritur 70% të mbulimit të kostos.

4.3 Para kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve është aprovuar një propozim për rritjen e tarifës nga bashkitë përkatëse dhe i është paraqitur rregullatorit (ERRU) që tregon qartësisht se UK Berat-Kuçovë mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit në vitin pasues, UK Fier mund të arrijë 95% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit për matësit e jashtëm të ujit) në vitin pasues, departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos në vitin pasues, UK Lushnjë mund të arrijë 75% të mbulimit të kostos në vitin pasues dhe UK Sarandë mund të arrijë 90% të mbulimit të kostos në vitin pasues.



4.4 Për më tepër ndërmarrjet e ujit do të zbatojnë masat e mëposhtme, me qëllim që të ngrenë normën e mbulimit të kostos:

Berat-Kuçovë:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20%/10%/10% në vitin 2012 dhe në vitin 2013;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjitha grupet e klientëve me të paktën 2%, duke filluar në vitin 2014;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe efijencë e stabilizuar në arkëtime.

Fier:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë me të paktën 16%/6%/10% për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike në vitin 2012 dhe në vitin 2013;
- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 35%/18%/25% në secilin prej dy viteve në vazhdim;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjitha grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2014;
- Efikasitet i përmirësuar arkëtimi në të paktën 85%;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogarimbajtje dhe komunikimi me klientët;
- Instalim i të paktën 25 000 matësve të ujit.

Kamëz:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 5% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014 dhe rritje e mëtejshme e tarifës sapo të jetë rritur norma e lidhjes;
- Sistem transparent për llogarimbajtjen në lidhje me ujin dhe kanalizimet që është e ndarë brenda administratës bashkiake;
- Stabilizimi i efijencës së arkëtimeve;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogarimbajtje dhe komunikim me klientët.

Lushnjë:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20%/15%/10% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;
- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 10% në vitin 2012, në vitin 2012 dhe në vitin 2014;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjitha grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;
- Efikasitet i përmirësuar në faturim dhe arkëtim.

Sarandë:

- Rritje vjetore e tarifës për furnizimin me ujë prej të paktën 15% për ekonomitë shtëpiake dhe të paktën 10% për shoqëritë private dhe institucionet publike në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;
- Normë e përmirësuar e faturimit dhe arkëtim, veçanërisht për turistët sezonalë dhe fshatrat rrethuese, që tarifohen për furnizim me shumicë.

4.5 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ofron fondet për rimbursimin e TVSH-së dhe detyrimeve doganore nga buxheti i tyre vjetor.

5. Dispozitat për operimin e duhur të programit

5.1 Për të siguruar operimin e duhur të programit, njësia e zbatimit të programit paraqet një koncept operimi dhe mirëmbajtjeje të përpiluar në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujit dhe konsulentin e zbatimit të paktën gjashtë muaj para autorizimit të investimit sipas programit.

5.2 Në të njëjtën kohë, agjencitë e zbatimit të programit i paraqesin KfW-së një parashikim financiar të përpiluar në pajtim me konsulentin e zbatimit për zonën e operimit në të cilin ndodhen nënprojektet. Ky parashikim duhet të tregojë që financimi për operimin është i siguruar. Agjencitë e

zbatimit të programit përditësojnë periodikisht këtë parashikim dhe sigurojnë që çdo boshllëk financiar të mbulohet në kohën e duhur. Agjencitë e zbatimit të programit ia transmetojnë KfW-së pa vonesë këtë parashikim financiar, si dhe versionet e tij të rishikuara.

6. Caktimi i një auditi

6.1 Një audit vjetor për përdorimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi European (auditi) kryhet sipas këtij programi. KfW-ja dhe Ministria e Financave rishikojnë nëse auditi mund të kryhet nga auditi i përzgjedhur nga Ministria e Financave.

6.2 Auditimi përzgjidhet pas ofrimit konkurrues ndërkombëtar dhe certifikon çdo vit përdorimin e duhur të kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi European deri në përfundimin e programit.

6.3 Auditimi i kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi European do të financohet nga kontributi financiar.

6.4 Termet e referencës për auditin do të bazohen në termet standardë të referencës së KfW-së që do t'i paraqiten KfW-së para caktimit të auditit.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga huaja përgatitet në bazë të kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Përkatësisht, KfW-së i jepet një kopje origjinale ose e thjeshtë e secilës prej kontratave të lartpërmendura dhe e çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse një masë e programit duhet të zbatohet pa marrëveshje dhe nuk janë lidhur kontratat, KfW-ja, në mungesë të kontratave, merr një grafik të masave të planifikuara, të ndara në kategoritë kryesore të kostos (grafiku i masave pa kontratë). Kostoja e shkaktuar për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punën pa kontratë nuk duhet të përfshihet në këtë grafik të masave pa kontratë.

1.3 KfW-ja njofton njësinë e zbatimit të programit me kërkesë për shumat e huas që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin 6 (procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European do të përdoret për të financuar kontratat për konsultim, mallra dhe shërbime që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar për nënprojektet në Berat-Kuçovë, Fier, Kamëz, Lushnjë dhe Sarandë.

Të gjitha shërbimet e konsulencës do të financohen ekskluzivisht nga fondet e BE-së. Pagesat sipas kontratave për mallrat dhe shërbimet do të disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European dhe huaja A dhe B e dhënë sipas bashkëpunimit financiar gjerman për këto kontrata.

Sipas ndarjes në aneksin 3, financimi i BE-së për Kamzën i referohet BMZ-nr. 2020 60 242, financimi i BE-së për Berat-Kuçovën, Fierin, Lushnjën dhe Sarandën i referohet BMZ-nr. 2020 60 408.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të dytë, njësinë e zbatimit të programit i raporton KfW-së në çdo semestër mbi përparimin e programit (raporte progresi) dhe të marrëveshjeve të zbatimit të parashikuara në seksionin II. 4 të kësaj marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme të rëndësishme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 7. Përveç kësaj, njësinë e zbatimit të programit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimit të programit dhe rezultateve. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të programit, por jo më vonë se mbarimi i periudhës së garancisë, njësinë e zbatimit të programit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e përmblitura. Raportet kërkohen në ditën e fundit të muajit pas çdo semestri viti (31 janar, 30 prill, 31 korrik dhe 31 tetor). Raporti i parë është i kërkueshëm më (të plotësohet). Raportet siglohen nga konsulentit.

1.2 Nëse njësinë e zbatimit të programit ka ngarkuar konsulentin të përpilojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, njësinë e zbatimit të programit komenton mbi raportet ose njeh aprovimin e përmblajtjes së tij duke sigluar raportet.



1.3 Pas përfundimit të programit, njësia e zbatimit të programit raporton mbi zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 7 për hollësi). KfW-ja informon rregullisht njësinë e zbatimit të programit në lidhje me përfundimin e periudhës së raportimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Njësia e zbatimit të programit dhe agjencitë e zbatimit të projektit i dërgojnë KfW-së ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura, brenda një kohe të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Huamarrësi vendos tabela programi që përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Qeverisë së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale Gjermane nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë programi e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logoja e Bashkimit Europian (dymbëdhjetë yje të verdha në një sfond blu) vendoset në tabelën e programit.

2.3 Të gjitha automjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulentët për programin do të transferohen te njësia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit. Prova dokumentuese për transferimin mbahet nga njësia e zbatimit të programit deri pesë vjet pas përfundimit të programit.

